
	<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova –</b> <b>Republic of Kosovo</b>	
	<b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština –Municipality of Prishtina	

<b>Datë/a:</b>	30.09.2022.
<b>Për/ Za/ To:</b>	Operatori Ekonomik: RENER shpk
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Nexhmi Mekolli – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 30.09.2022 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: RENER shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me tabela të menqura për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616-22-118-1-1-1** nxjerr:

## V E N D I M

1. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: RENER shpk e parashtruar me datë: 30.09.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me tabela të menqura për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616-22-118-1-1-1**, kundër **Njoftimit për Kontratë** të AK -së, të datës **25.08.2022** të publikuar në web-faqe të KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.
2. Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me tabela të menqura për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616-22-118-1-1-1**.
3. **Autoriteti Kontraktues mbështet çdo produkt që ofertoheq që ka specifika më të avancuara sesa përshkrimi i çmimit siç është paraqitur në sqarim të tenderit të datës: 26.09.2022**
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>